



Në bazë të nenit 4 të Vendimit për përcaktim të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 5/22) dhe nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën e përcaktimit dhe të pagesës së kompensimit të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak, numër 08-5213/1 të datës 04.05.2022, Qyteti i Shkupit shpall:

Thirrje publike
për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të zëvendësve të anëtarëve të Komisionit për veprim në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimet e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit nga ana e qenve endacak

1. Lënda

1.1 Lëndë e thirrjes publike është zgjedhja e anëtarëve të jashtëm dhe të zëvendësve të anëtarëve të Komisionit për veprim në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimet e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit nga ana e qenve endacak (në tekstin e më tutjeshëm: Komisioni), me sa vijon

- **1 (një) anëtarë dhe 1 (një) zëvendës anëtarë nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e traumatologjisë;**
- **1 mjek i licencuar nga fusha e psikiatrisë.**

1.2 Mandati i anëtarëve dhe i zëvendës anëtarëve të Komisionit është në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

1.3 Anëtarëve të Komisionit dhe zëvendësve të tyre, u paguhet kompensimi mujorë për pjesëmarrje në punën e Komisionit, në mënyrën vijuese:

- Anëtarëve nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e traumatologjisë dhe nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e psikiatrisë, u ndahet kompensimi në shumën prej **25.000,00** denarë, në neto shumë;
- Zëvendës anëtarëve të Komisionit, nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e traumatologjisë dhe nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e psikiatrisë, u ndahet kompensimi në shumën prej 25.000,00 denarë, mjete të cilat do tu paguhen gjatë muajve kur do ti zëvendësojnë anëtarët e Komisionit, për shkak të mungesës (mos pjesëmarrjes) së tyre në seancat e Komisionit.

2. Kushtet

2.1 Kandidatët nga nën pika 1.1. e thirrjes publike, duhet ti përmbushin kriteret vijuese:

- Të jenë nënshtrë të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të posedojnë licencë të vlefshme të punës, të dhënë nga Oda e mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të posedojnë së paku 5 (pesë) vite përvojë punë si mjek specialist në fushën përkatëse, në pajtim me nën pikën 1.1. të thirrjes publike.

2.2 Përvoja për nga aspekti i trajtimit të plagëve dhe lëndimeve të shkaktuara nga kafshimi i qenve (për traumatologun) ose përvoja e punës (diagnostifikimi) i personave që kanë pësuar frikë ose dhembje shpirtërore nga kafshimi i qenve (për psikiatrin), do të konsiderohet si përparësi.

3. Mënyrat e paraqitjes në Thirrjen publike

3.1 Personat të cilët i përmbushin kushtet nga pika 2 e kësaj thirrjeje, nevojitet që deri te Qyteti i Shkupit të dorëzojnë:

- Dokument të vlefshëm për identifikim personal (kopje),
- Kopje nga licenca e punës me vlefshmëri, e dhënë nga Oda e mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Dëshmi se posedon së paku 5 vite përvojë pune si mjek specialist i traumatologjisë ose si mjek specialist nga fusha e psikiatrisë në suaza të institucionit shëndetësorë – vërtetimin nga institucioni shëndetësorë,
- Biografinë në të cilën do të theksohet përvoja profesionale lidhur me trajtimin e plagëve dhe lëndimeve të shkaktuara nga kafshimi i qenve ose në lidhje me punën (diagnostifikimin) e personave që kanë pësuar frikë ose dhembje shpirtërore nga kafshimi i qenve (nga fusha e psikiatrisë).

4. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

4.1 Për realizimin e Thirrjes publike, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e thirrjes publike për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të zëvendësve të anëtarëve të Komisionit për veprim në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimet e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit nga ana e qenve endacak (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komisioni).

4.2 Komisioni për realizimin e thirrjes publike, në bazë të dokumenteve të parashtruara nga personat që kanë aplikuar, deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit, do të parashtrojë propozimin për zgjedhjen e anëtarëve dhe të zëvendës anëtarëve të Komisionit.

4.3 Nëse shfaqet nevoja, Komisioni për realizimin e thirrjes publike mund ti ftoj personat që janë paraqitur në thirrjen publike për realizimin e intervistës.

4.4 Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit për realizimin e thirrjes publike, do të miratoj Aktvendim për formim të Komisionit për veprim në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimet e qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit nga ana e qenve endacak.

5. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

5.1 Afati i parashtrimit është deri më datën **13.07.2022**.

5.2 Fletëparaqitjet me dokumentacionet e tërësishme duhet të dorëzohen deri te Qyteti i Shkupit përmes postës në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më vonë deri më datën **13.07.2022** deri në ora **15:00**, si ditë e fundit e përfundimit të thirrjes publike, me shenjë: "Thirrje publike për zgjedhjen e Komisionit për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak".

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur pa shënimin e subjektit i cili ka dorëzuar fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta, të cilat nuk janë dorëzuar në mënyrë e kërkuar dhe të përcaktuar me thirrjen publike, përkatësisht fletëparaqitjet që përmbajnë të dhëna dhe dokumente të pakompletuara, si dhe fletëparaqitjet që nuk do të dorëzohen në afatin e përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Pyetjet në lidhje me sqarime plotësuese që kanë të bëjnë me thirrjen publike, personat që janë të interesuar për aplikim, mund ti parashtrojnë deri te Sektori për punë juridike.

Telefoni për kontakte: (02)3297- 348 dhe (02)3297-259 si dhe në e mail adresën: Julijana.Bilkova@skopje.gov.mk

QYTETI I SHKUPIT